- Povucite četkicu na lijevu stranu i izvadite je. Možete koristiti četkicu za čišćenje za uklanjanje nakupljenih vlakana na metalnoj površini kondenzatora.



- Umetnite četkicu u njeno kućište gurajući udesno, nakon čišćenja kondenzatora, prednjeg poklopca i filtra vlakana.




- Nakon završetka procesa čišćenja, postavite vrata za vođenje vazduha na svoje mjesto, pomaknite zasune da biste ih zatvorili i zatvorite ploču.



### UPOZORENJE!

- Možete čistiti rukom, pod uslovom da nosite zaštitne rukavice. Ne pokušavajte da čistite golim rukama. Krilca kondenzatora mogu vam povrijediti ruke. Čišćenje pokretima lijevo-desno može oštetiti krilca kondenzatora. To može dovesti do problema sa sušenjem.




### UPOZORENJE!

- Normalno je vidjeti malo vode na plastičnoj površini ispred kondenzatora kada otvorite poklopac za usmjeravanje zraka.




### NAPOMENA

- Četkica je unutar vreće za tiskani materijal. Možete je smjestiti u njeno kućište na poklopcu za usmjeravanje zraka nakon prve upotrebe.



- Nakupljene dlačice na površini kondenzatora potrebno je ukloniti vlažnom krpom ili četkicom postavljenom na poklopcu za usmjeravanje zraka na kondenzatoru.
- Nemojte čistiti krilca kondenzatora u smjeru desno-lijevo kako biste izbjegli oštećenja.
- Za čišćenje možete koristiti i usisavač s četkicom. Nije preporučljivo čistiti kondenzator usisavačem bez četkice.



## 7 Rješavanje problema

Sušenje traje predugo.
Pore filtra vlakana (unutrašnji i spoljašnji filter) mogu biti začepljene. >>> Operite filter za dlačice toplom vodom i posušite. Prednja strana isparivača može biti začepljena. >>> Očistite prednju stranu isparivača. Ventilacijske rešetke na prednoj strani mašine mogu biti zatvorene. >>> Uklonite sve predmete koji blokiraju zrak ispred ventilacionih rešetki. Ventilacija može biti neadekvatna, jer je mašina instalirana u suviše malom prostoru. >>> Otvorite vrata ili prozore da biste sprečili da se temperatura u prostoriji poveća. Na senzoru vlažnosti može se nakupiti sloj kamenca. >>> Očistite senzor vlažnosti. Možda ste stavili preveliku količinu veša. >>> Nemojte previše napuniti sušilicu. Veš se možda nije okretao adekvatno. >>> Postavite veću brzinu centrifuge na mašini za pranje veša.
Veš izlazi vlažan nakon sušenja.
Možda nije korišten program koji nije prikladan za vrstu veša. >>> Provjerite naljepnice za održavanje na vešu i odaberite program prikladan za vrstu veša ili upotrijebite vremenske programe kao dodatne. Filter vlakana (unutrašnji i spoljašnji filter) može biti začepljen. >>> Operite filtre toplom vodom i posušite. Prednja strana isparivača može biti začepljena. >>> Očistite prednju stranu isparivača. Možda ste stavili preveliku količinu veša. >>> Nemojte previše napuniti sušilicu. Veš se možda nije okretao adekvatno. >>> Postavite veću brzinu centrifuge na mašini za pranje veša.
Sušilica se ne uključuje ili program ne može da se pokrene. Mašina za sušenje ne radi nakon podešavanja postavki.
Utičak može biti isključen iz struje >>> Vodite računa da strujni kabl bude uključen u utičnicu. Vrata za punjenje su možda otvorena. >>> Vodite računa da vrata za punjenje budu pravilno zatvorena. Možda program nije podešen ili možda niste pritisnuli tipku Start/Pauza/Prekid. >>> Provjerite da li je program izabran i da li je mašina u modu „Pauza“. Možda je aktivirana zaštita za djecu. >>> Isključite zaštitu za djecu.
Program se prekinuo prijevremeno bez razloga.
Vrata za punjenje mogu biti potpuno zatvorena. >>> Vodite računa da vrata za punjenje budu pravilno zatvorena. Možda je nestalo struje. >>> Pritisnite dugme start/pauza da pokrenete program. Rezervoar za vodu je možda pun. >>> Ispraznite rezervoar za vodu.
Veš se skupio, otvrdnuo ili rastegao.
Možda nije korišten prikladan program za tu vrstu veša. >>> Provjerite etikete za održavanje na vešu te izaberite program prikladan za tu vrstu veša.
Voda curi iz vrata za punjenje
Dlačice su se nakupile na unutrašnjim površinama vrata za punjenje i na površini zaptivke vrata za punjenje. >>> Očistite unutrašnje površine vrata za punjenje i površine zaptivke vrata za punjenje.

Vrata za punjenje se sama otvaraju.
Vrata za punjenje mogu biti potpuno zatvorena. >>> Gurnite vrata za punjenje dok se ne začuje zvuk zatvaranja.
Simbol upozorenja za rezervoar za vodu je uključen/bjeska.
Rezervoar za vodu je možda pun. >>> Ispraznite rezervoar za vodu. Crijevo za ispuštanje vode je možda puklo. >>> Ako je proizvod spojen direktno na odvod, provjerite crijevo za ispuštanje vode.
Svjetlo unutar sušilice se ne uključuje. (Kod modela sa lampicom)
Mašina za sušenje možda nije uključena pomoću dugmeta za uključivanje/isključivanje. >>> Proverite da li je mašina za sušenje uključena. Lampica je možda pokvarena. >>> Obratite se ovlaštenom servisu da biste zamijenili lampu.
Simbol upozorenja/LED svijetlo za spremnik za vodu je uključen/trepće.
Spremnik za vodu je možda pun. >>> Ispraznite spremnik za vodu. Crijevo za ispuštanje vode se možda otkacilo. >>> Ako je proizvod povezan direktno na odvod vode, provjerite crijevo za ispuštanje vode.
Simbol pare trepće. (Za proizvode sa funkcijom pare)
Spremnik za paru je možda prazan => Spremnik za paru napunite destilovanom ili kondenzovanom vodom.
Programi na paru ne mogu da se pokrenu (za proizvode sa funkcijom pare)
Spremnik za paru može biti prazan, ikona upozorenja spremnika za paru može zasvijetliti na ekranu => Napunite spremnik za paru dok se ikona pare ne ugasi.
Nabori se ne uklanjaju na programu za uklanjanje nabora. (Za proizvode sa funkcijom pare)
Možda je stavljeno previše rublja => Stavite određenu količinu rublja. Možda je odabrano vrijeme primjene pare na niskom nivou => Izaberite program sa velikom količinom pare. Možda je rublje dugo ostalo u mašini nakon završetka programa => Izvadite rublje čim se program završi i okačite ga.
Miris rublja se ne umanjuje na programu uklanjanja mirisa (za proizvode sa programom uklanjanja mirisa)
Možda je stavljeno previše rublja => Stavite određenu količinu rublja. Možda je odabrano vrijeme primjene pare na niskom nivou => Izaberite program sa velikom količinom pare.





## UPOZORENJE!

- Ako problem i dalje postoji nakon što ste slijedeli upute u ovom poglavlju, obratite se prodavcu ili ovlaštenom servisu. Nikad ne pokušavajte sami popraviti proizvod koji ne funkcioniра.



## NAPOMENA

- U slučaju da naiđete na problem na bilo kom dijelu uređaja, možete zatražiti zamjenu tako da kontaktirate ovlaštenu servis i navedete broj modela uređaja.
- Rad uređaja sa neautentičnim delovima može dovesti do kvara uređaja.
- Proizvođač i distributer nisu odgovorni za kvarove koji su rezultat korištenja neautentičnih dijelova.

## TEHNIČKE PODATKE PRODUKTA

U skladu sa Poverene uredbe Komisije (EU) br.: 392/2012

Ime dostavljača ili zaštitne marke		Beko
Ime modela		DS9430SX 7188235090
Nazivni kapacitet (kg)		9.0
Tip mašine za sušenje	Ispuhom zraka	-
	Kondenzator	•
Klasa energetske efikasnosti <sup>(1)</sup>		A++
Godišnja potrošnja energije (kWh) <sup>(2)</sup>		258,6
Tip kontrole	Automatski	•
	Neautomatski	-
Potrošnja energije standardne programe pamuka kod cijelog punjenja (kWh)		2,17
Potrošnja energije standardne programe pamuka kod djelimičnog punjenja (kWh)		1,16
Potrošnja energije u off-režimu standardne programe pamuka kod cijelog punjenja, P <sub>o</sub> (W)		0,50
Potrošnja energije u režimu „ostavljeno“ standardne programe pamuka kod cijelog punjenja P <sub>L</sub> (W)		1,00
Trajanje režima „ostavljeno“ (min)		30
Standardna programa pamuka <sup>(3)</sup>		•
Trajanje standardne programe pamuka kod cijelog punjenja T <sub>cy</sub> (min.)		209
Trajanje standardne programe pamuka kod djelimičnog punjenja T <sub>day1/2</sub> (min.)		119
Ponderirano vrijeme standardne programe pamuka kod cijelog i djelimičnog punjenja (T <sub>i</sub> )		158
Klasa efikasnosti kondenzacije <sup>(4)</sup>		B
Prosječni učinak kondenzacije standardnog programa za pamuk za maksimalno punjenje C <sub>day</sub>		81%
Prosječna efikasnost kondenzacije standardne programe pamuka kod djelimičnog punjenja, C <sub>day1/2</sub>		81%
Prosječni učinak kondenzacije standardnog programa za pamuk za djelimično punjenje C <sub>i</sub>		81%
Jačina zvuka standardne programe kod cijelog punjenja <sup>(5)</sup>		65
Ugrađeno		-

• : Da - : Ne

(1) Skala od A+++ (najefikasnije) do D (najmanje efikasnije)

(2) Potrošnja energije na osnovi 160 ciklusa sušenja standardne programe pamuka kod cijelog i djelimičnog punjenja i potrošnja u režimima niske potrošnje. Istinska potrošnja struje ovise o načinu upotrebe uređaja.

(3) Program „Pamuk, suh za u ormar“ upotrebjena kod cijelog ili djelimičnog punjenja je standardni program sušenja na kojeg se odnosi informacija na etiketi i u tehničke podatke, da je ovaj program pogodan za sušenje normalno mokrog pamučnog veša i da je najefikasniji program u smislu potrošnje energije za pamuk.

(4) Skala od G (najneefikasniji) do A (najefikasniji)

(5) Ponderirana prosječna vrijednost — L<sub>WA</sub> u dB(A) re 1 pW

## Ju lutemi të lexoni më parë manualin e përdoruesit!

I nderuar klient,

Ju falënderojmë që preferoni një produkt Beko. Shpresojmë që produkti juaj, i cili është prodhuar me cilësi dhe teknologji të lartë, t'iu ofrojë rezultatet më të mira. Ju këshillojmë që ta lexoni me kujdes të gjithin këtë manual dhe dokumentet shoqëruese përpara se ta përdorni produktin dhe t'i ruani që t'i referoheni në të ardhmen. Nëse ia jepni këtë produkt dikujt tjetër, jepini edhe këtë manual. Kushtojni vëmendje të gjitha detajeve dhe paralajmërimeve të specifikuara në manualin e përdoruesit dhe ndiqni udhëzimet e shprehura në të.

Përdorni këtë manual të përdoruesit për modelin e treguar në kopertinë.



- Lexoni udhëzimet.

## Shpjegimi i simboleve

Në të gjithë manualin e përdorimit janë përdorur simbolet e mëposhtme:



### RREZIK!

- Paralajmërim për goditje elektrike.



### RREZIK!

- Paralajmërim për rrezikun e zjarrit.



### KUJDES!

- Paralajmërim për situata të rrezikshme në lidhje me jetën dhe pronën.



### KUJDES!

- Paralajmërim për sipërfaqe të nxehta.



### KUJDES!

- Paralajmërim për rrezikun e djegies nga uji i nxehtë.



### SHËNIM

- Informacione të rëndësishme apo të dhëna të dobishme për përdorimin.



Materialet e paketimit të produktit prodhohen nga materiale të riciklueshme në përputhje me Rregulloret tona kombëtare për mjedisin.

Mos i hidhni materialet ambalazhuese së bashku me mbeturinat shtëpiake apo mbetjet e tjera, çojini ato në pikat e grumbullimit për materialet ambalazhuese të parashikuara nga autoritetet lokale.



“Ky produkt është prodhuar me teknologjinë më të fundit në kushte të përshtatshme për mjedisin.”

# 1 Udhëzime të rëndësishme për sigurinë dhe mjedisin



## SHËNIM

- Kjo pjesë përmban udhëzime për sigurinë të cilat do t'ju ndihmojnë që të mbroheni nga rreziqet e lëndimit apo dëmtimit të pronës. Mos-respektimi i këtyre udhëzimeve do të bëjë të pavlefshme të gjitha garancitë.

## 1.1 Siguria e përgjithshme



### KUJDES!

Pajisja mund të përdoret nga fëmijët e moshës 8 vjeç dhe më shumë dhe personat me aftësi të reduktuara fizike, ndijore ose mendore, ose me mungesë eksperience dhe njohurish, nëse monitorohen ose nëse janë udhëzuar me përdorimin e pajisjes në një mënyrë të sigurt dhe i kuptojnë rreziqet e përfshira. Fëmijët nuk duhet të luajnë me pajisjen. Pastrimi dhe mirëmbajtja nga përdoruesi nuk duhet të kryhen nga fëmijët e pamonitoruar. Fëmijët më të vegjël se 3 vjeç duhet të mbahen larg pajisjes përveç rastit kur janë në mbikëqyrje të vazhdueshme.

- Këmbët e rregullueshme nuk duhet të hiqen. Hapësira midis tharësës dhe dyshemesë nuk duhet të reduktohet me materiale të tillë si tapetat, druri apo shiritat. Kjo do t'i shkaktojë probleme tharësës.



### KUJDES!

Kryeni gjithmonë procedurat e instalimit dhe riparimit nga Shërbimi i autorizuar. Prodhuesi nuk do të mbajë përgjegjësi për dëmtime që mund të rrjedhin nga procedurat e kryera nga një person i paautorizuar.

- Mos e lani asnjëherë tharësen duke e sprucuar apo duke i derdhur ujë sipër! Ka rrezik të goditjes elektrike!

### Për produktet me funksion të avullit:



### KUJDES!

- Përdorni vetëm ujin e distiluar apo ujin e kondensuar në depozitat e ujit të pajisjes në programet e avullit. Mos përdorni ujë të rrjetit apo aditiv. Me rastin e përdorimit të ujit të kondensuar në depozitat e ujit, duhet të filtrohet dhe pastrohet nga fibrat.
- Mos hapni derën kur programet e avullit janë duke punuar. Uji i nxehtë mund të shpërthejë.
- Para futjes së rrobave në programin e avullit, njollat në to duhet të largohen.
- Ju mund të vendosni vetëm rrobat që nuk janë të palara apo me njolla por të lejuara me erë të pakëndshme në avull programi për (largimin e erës).
- Mos përdorni asnjë set të pastrimit me tharje apo materiale shtesë në programin me avull apo ndonjë program tjetër.

## 1.1.1 Siguria elektrike



### RREZIK!

- Udhëzimet për sigurinë elektrike duhet të ndiqen ndërsa kryhet lidhja elektrike gjatë instalimit.
- Pajisja nuk duhet të furnizohet me energji nëpërmjet një automati të jashtëm, si p.sh. automat me kohë, apo të lidhet me një qark që ndizet dhe fiket rregullisht nga shërbimi.
- Vendoseni tharësen në një prizë të tokëzuar të mbrojtur nga një siguresë sipas vlerës së specifikuar në etiketën e tipit. Instalimi i tokëzimit duhet të kryhet nga një elektrikist i kualifikuar. Kompania jonë nuk do të mbajë përgjegjësi për dëmtime që mund të shkaktohen kur tharësja përdoret pa tokëzim sipas rregulloreve lokale.
- Tensioni dhe mbrojtja e lejuar nga siguresa është e deklaruar në pllakëzën e etiketës së tipit.
- Tensioni i specifikuar në etiketën e tipit duhet të jetë i barabartë me tensionin e rrjetit.
- Hiqeni tharësen nga priza kur nuk është në përdorim.
- Hiqeni tharësen nga rrjeti gjatë instalimit, mirëmbajtjes, pastrimit dhe punimeve për riparimin.
- Mos e prekni spinën me duar të njoma! Mos e hiqni asnjëherë nga priza duke tërhequr kordonin, gjithmonë hiqeni duke kapur spinën.
- Mos përdorni kordonë zgjatues, pajisje me shumë priza apo adaptorë për ta lidhur tharësen me energjinë në mënyrë që të ulni rrezikun e zjarrit dhe goditjes elektrike.



### RREZIK!

- Priza e kablos së energjisë duhet të jetë lehtësisht e arritshme pas instalimit.
- Kablloja e rrjetit e dëmtuar duhet të ndërrohet duke njoftuar shërbimin e autorizuar.
- Nëse tharësja është me defekt, ajo nuk duhet të përdoret derisa të riparohet nga një agjent shërbimi i autorizuar. Ka rrezik të goditjes elektrike!

## 1.1.2 Siguria e produktit



### KUJDES!

- Sigurohuni që hyrja e ajrit për tharësen është e hapur dhe e ajrosur mirë.
- Produkti përmban lëng ftohës R290.
- R290 është një lëng ftohës i përshtatshëm për mjedisin, por i ndezshëm.
- Mbajeni produktin larg nga burimet e mundshme të nxehtësisë që mund të shkaktojnë ndezjen e tij.



### RREZIK!

- Nxehja shumë e lartë e rrobave brenda në tharëse mund të ndodhë nëse e anuloni programin ose në rast të ndërprerjes së energjisë kur tharësja është në punë, ky përqendrim i nxehtësisë mund të shkaktojë ndezje të vetvetishme dhe zjarr prandaj aktivizoni gjithmonë programin e ajrimit për ta ftohur ose hiqni shpejt të gjitha rrobat nga tharësja për t'i varur ato dhe për të shpërndarë nxehtësinë.



## RREZIK!

### **Çështje që duhet të merren në konsideratë për rrezikun e zjarrit:**

Rrobat apo artikujt e specifikuar më poshtë nuk duhet të thahen në tharëse duke marrë parasysh rrezikun e zjarrit:

- Rrobat e palara,
- Artikujt e ndotur me vaj, aceton, alkool, karburant, vajguri, largues të njollave, terpentinë, parafinë, largues të parafinës, naftë, dyllë ose largues dylli duhet të lahen me ujë të ngrohtë me detergjent të bollshëm përpara se të thahen në tharëse.

Për këtë arsye, sidomos për artikuj që kanë njollat e specifikuara më sipër, ato duhet të lahen shumë mirë. për të bërë këtë, përdorni një detergjent të përshtatshëm dhe zgjidhni një temperaturë të lartë për larjen.

### **Rrobat apo artikujt e specifikuar më poshtë nuk duhet të thahen në tharëse për shkak të rrezikut të zjarrit:**

- Veshje apo jastëkë të përforcuar me gomë peshku (shkumë qumështi), mbulesat e dushit, tekstilet që i rezistojnë ujit, materiale përforcues prej gome dhe mbushje të gomës së peshkut.

Veshjet që pastrohen me kimikate industriale.

Artikuj të tillë si çakmakët, shkrepëset, monedhat, pjesët metalike, gjilpërat etj. mund të dëmtojnë kazanin apo të çojnë në probleme me funksionimin. Prandaj kontrolloni të gjitha rrobat që do të vendosni në tharëse.



## RREZIK!

Mos e ndaloni asnjëherë tharësen para se të përfundojë programi.

- Nëse duhet ta bëni këtë, hiqni me shpejtësi të gjitha rrobat dhe hapini ato për të shpërndarë nxehtësinë. Veshjet të cilat lahen në mënyrë të papërshtatshme mund të ndizen vetë dhe madje mund të ndizen edhe pasi të përfundojë tharja.
- Duhet të siguroni ajrosje të mjaftueshme me qëllim që të parandaloni daljen e gazeve nga pajisjet që punojnë me lloje të tjera të karburanteve duke përfshirë flakët e hapura nga akumulimi në dhomë për shkak të efektit të zjarrit kthyes.



## KUJDES!

- Të brendshmet të cilat përmbajnë përforcues metalikë nuk duhet të thahen në tharëse. Tharësja mund të dëmtohet nëse përforcuesit metalikë lirohen apo shkëputen gjatë tharjes.



## SHËNIM

- Përdorni zbutës apo produkte të ngjashme në përputhje me udhëzimet e prodhuesve të tyre. Pastroni gjithmonë filtrin e linjtë para apo pas çdo ngarkese. Mos e përdorni asnjëherë tharëse pa instaluar filtrin e linjtë.



## KUJDES!

Mos u përpiqni asnjëherë që ta riparoni vetë tharësen. Mos kryeni asnjë riparim apo procedurë zëvendësimi në pajisje edhe nëse e dini apo keni aftësinë për ta kryer procedurën e kërkuar përveç rastit kur sugjerohet në mënyrë të qartë në udhëzimet e përdorimit apo në manualin e shërbimit të bërë publik. Në rast të kundërt, mund të vini në rrezik jetën tuaj dhe të tjerëve.

Nuk duhet të ketë derë që mbyllet, rrëshqitëse apo menteshë që të bllokojë hapjen e derës së ngarkimit në vendit ku do të instalohet tharësja.

Instaloheni tharësen tuaj në vende të përshtatshme për përdorim shtëpiak. (banjë, ballkon i mbyllur, garazh etj.)

Sigurohuni që kafshët shtëpiake të mos hyjnë në tharëse. Kontrolloni pjesën e brendshme të tharëses përpara se ta vini në punë.

Mos u varni në derën e ngarkimit të tharëses tuaj kur është e hapur, në rast të kundërt mund të rrëzohej.

Mbetjet e linjta nuk duhet të lejohen që të grumbullohen brenda tharëses.

Tharësja me kazan nuk duhet të përdoret nëse janë përdorur kimikate industriale për pastrimin.



## KUJDES!

Zbutësit e rrobave, ose produkte të ngjashme, duhet të përdoren siç specifikohet nga udhëzimet e zbutësit të rrobave.

Ajri i shkarkimit nuk duhet të kalojë në një kanal që përdoret për shkarkimin e tymrave nga pajisje djegëse me gaz ose lëndë të tjera djegëse.

### 1.2 Montimi mbi makinën larëse

- Duhet të përdoret një pajisje mbërthëse midis të dyja pajisjeve kur tharësja instalohet mbi makinën larëse. Pajisja mbërthëse duhet të instalohet nga një agjent shërbimi i autorizuar.
- Pesha totale e makinës larëse dhe tharëses - me ngarkesë të plotë - kur janë të vendosura mbi njëra-tjetrën arrin afërsisht në 180 kilogramë. Vendosini produktet në një dysheme të ngurtë e cila ka kapacitet të mjaftueshëm mbajtës!



## KUJDES!

- Makina larëse nuk mund të vendoset mbi tharëse. Kushtojini vëmendje paralajmërimeve të mësipërme gjatë instalimit të makinës tuaj larëse.

Tabela e instalimit për makinën larëse dhe tharësen

Thellësia e tharëses	Thellësia e makinës larëse			
	62 cm	60 cm	54 cm	< 50 cm
54 cm	Mund të instalohet		Nuk mund të instalohet	
60 cm	Mund të instalohet		Nuk mund të instalohet	

### 1.3 Përdorimi i synuar

- Tharësja është projektuar për përdorim shtëpiak. Nuk është e përshtatshme për përdorim në biznes dhe nuk mund të përdoret jashtë përdorimit të saj të synuar.
- Përdorëni tharësen vetëm për të tharë rroba të cilat kanë shenjë përkatëse.
- Prodhuesi heq dorë nga përgjegjësia që lind nga përdorimi apo transporti jo i duhur.
- Jeta e shërbimit të tharëses që keni blerë është 10 vjet. Gjatë kësaj periudhe do të ketë në dispozicion pjesë këmbimi që tharësja të funksionojë siç duhet.

### 1.4 Siguria për fëmijët

- Materialet ambalazhuese janë të rrezikshme për fëmijët. Mbajni materialet ambalazhuese larg fëmijëve.
- Produktet elektrike janë të rrezikshme për fëmijët. Mbajni fëmijët larg produktit kur ai është në punë. Mos i lejoni ata që ta ngacmojnë tharësen. Përdorni kyçjen për fëmijët me qëllim që t'i parandaloni ata që ta ngacmojnë tharësen.



#### SHËNIM

Kyçja për fëmijët gjendet në panelin e kontrollit.  
(Shihni Kyçjen për fëmijët)

- Mbajeni derën e ngarkimit të mbyllur edhe kur tharësja nuk është në përdorim.

### 1.5 Pajtimi me rregulloren e WEEE dhe asgjësimi i produktit



Ky produkt është në përputhje me Direktivën evropiane WEEE (2012/19/EU). Ky produkt ka një simbol klasifikimi për pajisjet elektrike dhe elektronike të përdorura (WEEE).

Ky produkt është prodhuar me pjesë dhe materiale me cilësi të lartë, të cilat mund të ripërdoren dhe janë të përshtatshme për riciklim. Mos e hidhni produktin e përdorur bashkë me mbeturinat familjare dhe mbeturinat e tjera në fund të jetës së shërbimit të produktit. Çojeni atë në qendrën e grumbullimit për riciklimin e pajisjeve elektrike dhe elektronike. Këshillohuni me autoritetet lokale për të mësuar mbi këto qendra të grumbullimit.



#### RREZIK!

- R290 është një lëng ftohës i ndezshëm. Për këtë arsye, sigurohuni që sistemi dhe tubat nuk dëmtohen gjatë përdorimit dhe manovrimit.
- Mbajeni produktin larg nga burimet e mundshme të nxehtësisë që mund të shkaktojnë ndezjen në rast dëmtimi.
- Mos e hidhni produktin pas përdorimit duke i vënë zjarrin.

### 1.6 Pajtimi me direktivën RoHS:

Produkti që keni blerë është i pajtueshëm me Direktivën EU RoHS (2011/65/EU). Ai nuk përmban materiale të dëmshme dhe të ndaluara të specifikuara në Direktivë.

### 1.7 Informacione për ambalazhin

Materialet e paketimit të produktit prodhohen nga materiale të riciklueshme në përputhje me Rregulloret tona kombëtare për mjedisin. Mos i hidhni materialet e paketimit bashkë me mbeturinat familjare ose mbeturinat e tjera. Çojini ato te pikat e grumbullimit për materialet e paketimit të përcaktuara nga autoritetet lokale.



## 1.8 Specifikimet teknike

AL

Lartësia (min. / maks.)	84,6 cm / 86,6 cm*
Gjerësia	59,7 cm
Thellësia	65,4 cm
Kapaciteti (maks.)	9 kg**
Pesha neto (± %10)	48 kg
Voltazhi	Shiko etiketën e tipit***
Energjia nominale në hyrje	
Kodi i modelit	

\* Lartësia min.: Lartësia me këmbë të rregullueshme të mbyllura.

Lartësia maks.: Lartësia me këmbë të rregullueshme të hapura në maksimum.

\*\* Thani ngarkesën e rrobave para larjes.

\*\*\* Etiketa e tipit gjendet në pjesën e pasme të derës së ngarkimit.




### SHËNIM

- Specifikimet teknike të tharëses janë objekt i ndryshimeve pa një njoftim paraprak për të përmirësuar cilësinë e produktit.
- Figurat në këtë manual janë skematike dhe mund të mos përputhen me saktësi me produktin.
- Vlerat e shënuara në treguesit në tharëse ose në dokumentacione të tjera të botuara që shoqërojnë tharësen janë marrë në laboratorë në përputhje me standardet përkatëse. Këto vlera mund të ndryshojnë në varësi të kushteve operative dhe mjedisore.

## 2 Tharësja juaj

### 2.1 Përmbledhje



1. Paneli iartë
2. Paneli i kontrollit
3. Dera e
4. Goditni tastin për hapjen e pllakës
5. Rrjetat e ventilimit
6. Këmbët e rregullueshme
7. Në modelet ku depozita është e vendosur poshtë, depozita e ujit është brenda panelit mbrojtës të poshtëm
8. Etiketa e tipit
9. Filtri i pushit
10. Rafti i depozitës së ujit (në modelet ku depozita është vendosur lart)
11. Kablo e energjisë

### 2.2 Përmbajta e ambalazhit

	1. Tubi i shkarkimit të ujit *		6. Ena për mbushjen e ujit*
	2. Sfungjeri rezervë për sirtarin e filtrit*		7. Uji i pastër*
	3. Manuali i përdoruesit		8. Grupi i kapsulave të aromës*
	4. Koshi i tharjes*		*9. Furça*
	5. Manuali i përdorimit të koshit të tharjes*		10. Filtri tekstil*

\*Opsionale - mund të mos përfshihet, në varësi të modelit.

### 3 Instalimi

Para se të telefononi qendrën më të afërt të shërbimit të autorizuar për montimin e tharësës, sigurohuni që instalimet elektrike dhe shkarkimi i ujit t'i referohen si duhet manualit të përdorimit. Nëse nuk janë të përshtatshëm, kontaktoni me një elektricist ose teknik të kualifikuar për të bërë sistemimet e duhura.



#### SHËNIM

- Përgatitja e vendndodhjes së tharësës si dhe instalimet elektrike e të ujit të papastër janë përgjegjësi e klientit.



#### KUJDES!

- Përpara instalimit, kontrolloni me sy nëse tharësja ka ndonjë defekt. Nëse tharësja është e dëmtuar, mos e instaloni. Produktet e dëmtuara përbëjnë rrezik për shëndetin tuaj.
- Lëreni tharësen të presë për 12 orë para se të filloni ta përdorni.

#### 3.1 Vendndodhja e përshtatshme për instalimin

Instalojeni tharësen në një sipërfaqe të qëndrueshme dhe në nivel. Tharësja është e rëndë. Mos e zhvendosni vetë.

- Vëreni në punë tharësen në një mjedis të ajrosur dhe pa pluhura.
- Hapësira midis tharësës dhe sipërfaqes nuk duhet të reduktohet nga materiale të tilla si tapetat, druri dhe shiritat.
- Mos e mbulonit rjetën e ajrosjes së tharësës.
- Nuk duhet të ketë derë që mbyllet, rrëshqitëse apo menteshë që të bllokojë hapjen e derës së ngarkimit në vendit ku do të instalohet tharësja.
- Pasi tharësja të jetë instaluar, ajo duhet të qëndrojë në të njëjtin vend ku është bërë lidhja e saj. Kur të instaloni tharësen sigurohuni që pjesa e pasme të mos prekë askund (rubinet, prizë, etj).
- Vendoseni tharësen të paktën 1 cm larg nga skajet e pajisjeve të tjera.

- Tharësja juaj mund të punojë në temperatura midis +5 °C dhe +35°C. Nëse kushtet e funksionimit janë jashtë kësaj game, funksionimi i tharësës do të ndikohet negativisht dhe mund të dëmtohet.
- Sipërfaqja e pasme e tharësës duhet të vendoset pas murit.



#### RREZIK!

Mos e vendosni tharësen mbi kabllon elektrike.

\* Injoroni paralajmërimet e mëposhtme nëse sistemi i produktit tuaj nuk përmban R290.



#### RREZIK!

- Tharësja përmban lëng ftohës R290.\*
- R290 është një lëng ftohës i përshtatshëm për mjedisin, por i ndezshëm.\*
- Sigurohuni që hyrja e ajrit për tharësen është e hapur dhe e ajrosur mirë.\*
- Mbajini burimet e mundshme të flakëve larg nga tharësja.\*

#### 3.2 Heqja e grupit të sigurisë së transportit



#### KUJDES!



- Hiqni grupin e sigurisë së transportit përpara se ta përdorni tharësen për herë të parë.
- Nëse ana e hapjes së derës për pajisjen tuaj mund të modifikohet, shikoni udhëzimet për montimin e derës në të kundërt.





### 3.3 Lidhja e tubit të shkarkimit të ujit në produktet me veçorinë e avullit

Mund ta shkarkoni drejtpërdrejt ujin e grumbulluar nëpërmjet tubit të shkarkimit të ujit të siguar së bashku me produktin, në vend që të shkarkoni periodikisht ujin e grumbulluar në depozitën e ujit.



#### SHËNIM

- Ndriqni diagramin më poshtë për të lidhur tubin e shkarkimit të ujit nëse tharësja juaj është e pajisur me veçorinë e spërkatjes së avullit.




- Tërhiqni me duar tubin në pjesën e pasme të tharësës me qëllim që ta shkëputni nga vendi ku është lidhur. Mos përdori asnjë vegël për të hequr tubin.
- Instaloni skajin B të tubit të shkarkimit të ujit që keni marrë me pajisjen tuaj te skaji i tubit që keni hequr nga pajisja.
- Instaloni skajin A të tubit të shkarkimit të ujit që keni marrë me pajisjen tuaj te vendi ku keni hequr tubin në tharëse.
- Fiksioni skajin C të tubit të shkarkimit të ujit te tubi i shkarkimit të ujit të përdorur ose drejtpërdrejt te lavamani.



#### SHËNIM

- Tubi i shkarkimit të ujit duhet të lidhet në një lartësi maksimumi 80 cm.
- Sigurohuni që tubi i shkarkimit të ujit të mos jetë shkelur apo përthyer midis pikës së shkarkimit dhe pajisjes.
- Nëse ka pako të pjesëve shtesë me produktin tuaj, ju lutemi shihni përshkrimin e detajuar.

### 3.4 Rregullimi i këmbëve



- Rrotulloni këmbët nga e majta apo nga e djathta derisa tharësja të qëndrojë në nivel dhe e palëvizshme.

### 3.5 Transporti i tharësës

Shkarkoni të gjithë ujin që ka mbetur në tharëse.



Nëse është kryer lidhje e drejtpërdrejtë me shkarkimin e ujit, hiqni lidhjet me tubin.



#### KUJDES!

- Ju rekomandojmë që ta mbani tharësen në pozicionin me kokë sipër. Nëse nuk është e mundur që ta mbani pajisjen në pozicionin me kokë sipër, ju rekomandojmë që ta mbani të anuar nga pjesa e djathtë kur tharësja shihet përballë.

### 3.6 Paralajmërimet për tingujt

	<b>SHËNIM</b>
	<ul style="list-style-type: none"><li>• Është normale që ndonjëherë të dëgjoni një zhurmë metalike nga kompresori gjatë punës.</li></ul>
<ul style="list-style-type: none"><li>• Uji i mbledhur gjatë punës pompohet te depozita e ujit. Gjatë këtij procesi është normale të dëgjoni zhurma pompimi.</li></ul>	

### 3.7 Ndërrimi i llambës së ndriçimit

Në rast se në tharësen tuaj të rrobave përdoret një llamba ndriçuese. Për të ndërruar llambën/LED që përdoret për ndriçimin e tharëses, telefononi Shërbimin e autorizuar. Llamba(t) e përdorur në këtë pajisje nuk është e përshtatshme për ndriçimin e dhomës së shtëpisë. Qëllimi i synuar i kësaj llambe është që të ndihmojë përdoruesin që të vendosë lehtësisht rrobat në tharëse. Llambat e përdorura në këtë pajisje duhet të përballojnë kushte fizike ekstreme, si dridhje dhe temperatura mbi 50 °C.

## 4 Përgatitja

### 4.1 Rrobat e përshtatshme për t'u tharë në tharëse

Respektoni gjithmonë udhëzimet e dhëna në etiketat e veshjeve. Thani vetëm rrobat që kanë një etiketë ku thuhet se janë të përshtatshme për tharje në tharëse.

### 4.2 Rroba që nuk janë të përshtatshme për t'u tharë në tharëse



Artikujt me këtë simbol nuk duhet të thahen në tharëse.



#### SHËNIM

- Pëlhurat delikate të qëndisura, të leshtat, veshjet e mëndafshata, veshjet delikate dhe me vlerë, artikujt e papërshkueshëm nga ajri dhe tylet e perdet nuk janë të përshtatshme për t'u tharë në pajisje.

### 4.3 Përgatitja e rrobave për t'u tharë


- Rrobat mund të përzihen me njëra-tjetrën pas larjes. Ndajini ato përpara se t'i vendosni në tharëse.
- Thajini së prapthi rrobat të cilat kanë aksesore të tillë si zinxhirët.
- Mbërtheni zinxhirët, sustat, tokëzat dhe kopsat.

### 4.4 Gjëra që duhen bërë për të kursyer energji

- Centrifugojini rrobat tuaja me shpejtësinë më të madhe të mundshme kur t'i lani. Në këtë mënyrë, shkurtohet koha e tharjes dhe reduktohet konsumi i energjisë.
- Ndajini rrobat në varësi të llojit dhe trashësisë. Thani së bashku të njëjtat lloje të rrobave. Për shembull, peshqirët e hollë të kuzhinës dhe mbulesat e tavolinës thahen më shpejt se peshqirët e banjës.
- Ndiqui udhëzimet në manualin e përdorimit për përzgjedhjen e programit.
- Mos e hapni derën e ngarkimit të pajisjes gjatë tharjes përveç rasteve kur kjo është e nevojshme. Nëse ju duhet që të hapni derën e ngarkimit, mos e mbani hapur për një kohë të gjatë.

- Mos shtoni rroba të lagura ndërkohë që tharësja është në punë.
- Për modelet me njësi kondensatori: patroni kondensatorin njëherë në muaj apo pas çdo 30 operacioneve të rregullta.
- Pastroni filtrin në mënyrë periodike. Lexoni pjesën e mirëmbajtjes dhe pastrimit të filtrave për informacione të detajuara.
- Për modelet me njësi të nxehtësisë: përbajuni instruksioneve për lidhjen e nxehtësisë dhe pastrimin e saj.
- Gjatë procesit të tharjes, bëni ajrosjen e dhomës mirë ku operon tharësi juaj.

### 4.5 Kapaciteti i duhur i ngarkimit



Ndiqui udhëzimet në "Tabelën e përzgjedhjes së programit dhe konsumit". Mos ngarkoni më tepër rroba sesa vlerat e kapacitetit të treguara në tabelë.


Peshat në vijim janë marrë si shembull.

Rrobat	Peshat e përafërta (g)*	Rrobat	Peshat e përafërta (g)*
Batanije pambuku (dyshe)	1500	Bluza	150
Batanije pambuku (teke)	1000	Këmisha pambuku	300
Çarçafë krevati (dyshe)	500	Këmisha	250
Çarçafë krevati (tek)	350	Fustane pambuku	500
Mbulesa tavoline të mëdha	700	Fustane	350
Mbulesa tavoline të vogla	250	Xhinset	700
Peceta çaji	100	Shami (10 copë)	100
Peshqirë banje	700	Bluza me mëngë të shkurtra	125
Peshqirë duarsh	350		

\*Peshojeni peshën e larësve para larjes..

## 5 Kyçja e produktit


### 5.1 Paneli i kontrollit



1. Çelësi i Ndezjes/Fikjes/Përzgjedhjes së Programit.
2. Butoni i Fillimit / Pushimit.
3. Butoni i dritës së kazanit.
4. Butoni i përzgjedhjes së kohës së përfundimit.


5. Butoni i përzgjedhjes së programit kohor.
6. Butoni i përzgjedhjes së temperaturës së ulët.
7. Butoni i përzgjedhjes së paralajmërimit me zë dhe i çelësit për fëmijë.
8. Butoni i përzgjedhjes së parandalimit të rrudhave.
9. Butoni i përzgjedhjes së nivelit të thatësisë.

### 5.2 Simbolet



### 5.3. Përgatitja e pajisjes tharëse

- Kyçeni pajisjen për tharje.
- Hapni derën e ngarkimit.
- Vendosni rrobat në pajisjen për tharje pa i bllokuar ato.
- Shtyni dhe mbyllni derën e ngarkesës.



- Përzgjidhni programin e dëshiruar duke përdorur çelësin On/Off/Program Selection, pajisja do të ndizet.




#### SHËNIM!

- Kur përzgjidhni programin me çelësin On/Off/Program Selection kjo nuk do të thotë se programi ka filluar. Shtypni butonin Start / Stand-by për të filluar programin.

## 5.4 Zgjedhja e programit dhe tabela e konsumit

AL				
Programet	Përshkrimi i programit	Kapaciteti (kg)	Shpejtësia e rrotullimit në lavatërçe (rrotullime/min)	Koha e tharjes (min)
Të pambuktat	Mund t'i thani me këtë cikël tekstilet e pambukta rezistente ndaj nxehtësisë. Do të zgjidhet një përcaktim i tharjes që është i përshtatshëm për trashësinë e rrobave që do të thani dhe nivelin e dëshiruar të tharjes.	9	1000	220
Ekonomik për pambuk	Veshjet e përditshme tekstile të pambukta me një shtresë thahen në mënyrë sa më ekonomike.	9	1000	209
Veshjet e pambukta gati për hekurosje	Veshjet e përditshme tekstile të pambukta me një shtresë thahen pak të njoma që të jenë gati për hekurosje.	9	1000	160
Sintetiket	Mund t'i thani me këtë cikël të gjitha tekstilet sintetike. Do të zgjidhet një përcaktim i tharjes që është i përshtatshëm për nivelin e dëshiruar të tharjes.	4	800	80
Hygienic Drying	Ky është programi me të cilin mund të thani artikujt tuaj të larë të cilët dëshironi t'i higjienizoni më tej (rrobat e fëmijëve, veshjet e brendshme, peshqirët, etj.) Ai siguron higjienë të lartë për tekstilet tuaja nëpërmjet efektit të nxehtësisë.	5	800	200
Hygienic Refresh	Mund ta përdorni këtë program për veshjet dhe rrobat e thara që doni t'i higjienizoni pa i larë ato. Ai siguron higjienë të lartë për tekstilet tuaja të thara, nëpërmjet efektit të nxehtësisë.	1,5	-	120
Shtroja shtrati	Me këtë program mund të thani produktet tuaja tekstile të mbushura me fibra. Kontrolloni përshtatshmërinë e tekstileve për tharjen në tharëse dhe thajini ato sipas udhëzimeve.	-	800	165
Pupla	Me këtë program mund të thani produktet tuaja tekstile të mbushura me pupla. Kontrolloni përshtatshmërinë e tekstileve për tharje në tharëse dhe thajini ato sipas udhëzimeve.	-	800	125
Tharësja e rrobave / Kohëzgjatja e tharjes	Mund të zgjidhni nga programet kohore me kohëzgjatje nga 10 dhe 160 minuta për të arritur nivelin e dëshiruar të tharjes në temperaturë të ulët. Në këtë program, procesi i tharjes zgjat për kohën e caktuar, pavarësisht nga thatësia e rrobave të vendosura. Ky produkt mund të përdoret me një kosh tharjeje si alternativë. Për produktet që shiten pa kosh, ju mund të merrni një kosh në një nga shërbimet tona të autorizuara dhe të përdorni programet e tharjes të specifikuar më sipër. Për më shumë hollësinë lidhje me përdorimin, shihni udhëzuesin e përdorimit të koshit të tharjes.	-	-	-
Ekspres	Përdorni këtë program për të pasur 2 këmisha gati për hekurosje.	0,5	1200	30
Towel	Tharja e peshqirëve si p.sh. peshqirë kuzhine, peshqirë banje dhe duarsh.	5	1000	175



Veshje për ambiente të jashtme/sporte (Goretex)	Përdoreni për të tharë rrobat tuaja prej sintetike, pambuku ose pëlhura të përziera, ose produkte kundër ujit si xhaketa funksionale, xhaketa kundër shiut etj. Kthejini në të kundërt para se t'i thani.	2	1000	135
Vlerat e konsumit të energjisë				
Programet	Kapaciteti (kg)	Shpejtësia e rrotullimit në lavatrise (rrotullime/min)	Sasia e përafërt e lagështisë së mbetur	Vlerat e konsumit të energjisë në kWh
Ekonomik për pambuk*	9	1000	60%	2,17
Veshjet e pambukta gati për hekurosje	9	1000	60%	1,65
Veshjet sintetike gati për t'u veshur	4	800	40%	0,75
	"Programi Ekonomik për pambuk" i përdorur me ngarkesë të plotë dhe të pjeshme është programi standard i tharjes me të cilin lidhen informacionet në etiketë dhe në skedën e të dhënave - ky program është i përshtatshëm për tharjen e rrobave normale të lagura prej pambuku dhe ai është programi më efikas në kuadër të konsumit të energjisë për veshjet e pambukut.			

\* : Etiketa e Energjisë programi standard (EN 61121) Vlerat në tabelë janë përcaktuar sipas standardit EN 61121 Vlerat e konsumit mund të ndryshojnë nga vlerat në tabelë në varësi të llojit të rrobave, shpejtësisë së centrifugimit, kushteve të ambientit dhe niveleve të tensionit.

## Shpjegime të Përgjithshme të Programeve të Avullit

Emri i programit	Kohëzgjatja e programit	Definicioni i programit	Kapaciteti
Hekurosje e lehtë	50 min.	Rrobat e pambukut për përdorime të përditshme dhe rrobat sintetike janë të përshtatshme për këtë programin. Që të parandalojmë rrudhat mbi rrobat mund të përdorim programin Easy Iron (hekurosje e lehtë). Kjo programë është e përshtatshme vetëm për lavanderinë e lagur.	1,5 kg rroba pambuku ose sintetike / 5-6 këmisha
	45 min.		1 kg rroba pambuku ose sintetike / 3-4 këmisha
	44 min.		0,5 kg rroba pambuku ose sintetike / 1-2 këmisha
Pantallona	130 min. 135 min. (avull)	Në këtë program mund të thani pantallona, funde, këmisha ose xhaketat. Nëse zgjedhet opsioni i avullit, aromat e këqija dhe rrudhat do të largohen nga lavateria me zbatimin e avullit.	4kg
GentleCare (Kujdes i butë)	50 min. 55 min. (avull)	I thanë rrobat në mënyrë delikate duke shkaktuar më pak rrudha dhe hekurosje më të lehtë. Nëse zgjedhet opsioni i avullit, aromat e këqija dhe rrudhat do të largohen nga lavateria me zbatimin e avullit.	1,5 kg
Mix (Përzjerje)	115 min. 120 min. (avull)	Përdoreni këtë programë për të tharë artikuj ose rroba sintetike pa pigment ose të pambukut bashkërisht. Rrobat për sport ose për fitnes poashtu mund të thahen me këtë programë. Nëse zgjedhet opsioni i avullit, aromat e këqija dhe rrudhat do të largohen nga lavateria me zbatimin e avullit.	4kg



Allergy UK është marka tregtare e Fondacionit Britanik për Alergjinë. Vula e Aproximit është krijuar për të udhëzuar personat që kërkojnë një këshillë se produkti e redukton

në mënyrë domethënëse sasinë e alergjenëve në një mjedis ku janë të pranishëm persona alergjikë ose produkti i kufizon/redukton/eliminon alergjenët. Qëllimi është për të dëshmuar se produktet janë testuar ose analizuar në mënyrë shkencore për të dhënë rezultate të matshme.

### 5.5 Funksonet ndihmëse

#### Niveli i thatësisë

Butoni i nivelit të thatësisë përdoret për ta rregulluar në thatësinë e dëshiruar. Koha e programit mund të ndryshojë në varësi të përzgjedhjes.



#### SHËNIM!

- Mund ta aktivizoni këtë funksion vetëm para fillimit të programit.

#### Parandalimi i rrudhave

Mund ta aktivizoni dhe ta çaktivizoni funksionin e parandalimit të rrudhave duke shtypur butonin e përzgjedhjes së parandalimit të rrudhave. Nëse nuk do t'i nxirni jashtë rrobat menjëherë pasi programi ka përfunduar, mund të përdorni funksionin e parandalimit të rrudhave për të parandaluar rrudhosjen e rrobave tuaja.

#### Paralajmërimi me zë

Pajisja për tharje lëshon një paralajmërim me zë kur përfundon programi. Shtypni butonin "Audible Warning" nëse nuk doni paralajmërimin me zë. Kur shtypni butonin e paralajmërimin me zë, drita fiket dhe nuk lëshohet tingull kur programi përfundon.



## SHËNIM!

- Mund ta përzgjidhni këtë funksion para se programi të fillojë ose pasi programi ka filluar.

### Temperatura e ulët

Mund ta aktivizoni këtë funksion vetëm para se të fillojë një program. Mund ta aktivizoni këtë funksion nëse doni t'i thani rrobat tuaja në një temperaturë më të ulët. Kohëzgjatja e programit do të jetë më e gjatë pasi të aktivizohet.

### Koha e përfundimit

Mund ta shtyni kohën e përfundimit të programit deri në 24 orë me funksionin e kohës së përfundimit.

- Hapni derën e ngarkesës dhe vendosni rrobat.
- Përzgjidhni programin e tharjes.
- Shtypni butonin e përzgjedhjes së kohës së përfundimit End Time dhe përcaktoni kohën e shtyrjes nëse dëshironi. Ndizet drita LED e Kohës së Përfundimit. (Kur e mbani të shtypur butonin, Koha e përfundimit do të vazhdojë pa ndalim).
- Shtypni butonin Start / Stand-by. Fillon numërimi mbrapsht i Kohës së Përfundimit. Shenja “.” në mes të kohës së shtyrë të shfaqur pulson.



## SHËNIM!

